



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	17-03-2023	3	vit god yazi
Organ /Njesia Organ /Jodnica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHK/SHK	2793/2023		1/1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKË QYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.302/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.302/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi [ ] i me adresë banimi: Rruga "Astrit Rushi", K-1, B-5-1, Objekti DS Construcion, Lagja e Spitalit në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër: 06/2023 i datës 25.01.2023 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 17.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.302/2023 e datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër: 06/2023 i datës 25.01.2023 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës.

A r s y e t i m

Ankuesi [ ] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Inspektoratin e Punës, më datë 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1244/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me 06/2023 të datës 25.01.2023 i Menaxheri të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se inspektorati i Punës me rastin e korrigjimit të akt emërimit Nr.57/2017 i datës 06.03.2017 lidhur me titullin e pozitës së punës, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe ka shkelur dispozitat e ligjit material sikurse ka shkelur dispozitat e

nenit 58 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ngase ka kaluar afati prej pesë (5) vitesh për shfuqizimin apo anulimin e aktit administrativ.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 22.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Inspektorati i Punës. Ndërsa me datën 07.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1244/2023 të datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Inspektoratit të Punës me numër 06/2023 i datës 25.01.2023; Vendim për shfrytëzimin e pushimit vjetor me nr.prot.22/2022 i datës 03.03.2022; Vendim për shfrytëzimin e pushimit vjetor me nr.prot.15/2021 i datës 19.06.2021; Vendim për shfrytëzimin e pushimit vjetor me nr.prot.11/2021 i datës 15.05.2021; E-maili i dërguar nga F.G drejtuar N.S i datës 25.08.2022; Vendim me nr.prot.150 i datës 18.01.2023; Lista menaxherave të IT në institucione; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 me nr.prot.38/2019 i datës 10.01.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 me nr.prot.22/2018 i datës 15.01.2018; Akt emërimi me nr.prot.57/2017 i datës 06.03.2017; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 22.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 07.03.2023; Akt emërimi me nr.prot.321 i datës 18.05.2015; Vendim i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me nr.prot.35 i datës 15.02.2017; Lista e pagave për muajin Janar; Lista e pagave për muajin Shkurt.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër prot. 321 të datës 18.05.2015 ka qenë i emëruar në pozitën "Menaxher i Sistemit Informativ dhe Analizave në Tregun e Punës" në Departamentin për Punë dhe Punësim në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa përmes Vendimit me numër të protokoll 35/2017 të datës 15.02.2017 është bërë transferimi i ankuesit në vendin e punës "Zyrtarë i Lartë për Teknologji Informativ" në Inspektoratin e Punës, mirëpo me rastin e përpilimit të akt emërimit me nr.prot.57/2017 të datës 06.03.2017 nga inspektorati i Punës, ankuesit i është caktuar gabimisht titulli i vendit të punës si "Menaxher i TI-së".

Tutje, Inspektorati i Punës përmes Vendimit me numër 06/2023 të datës 25.01.2023 ka bërë korigjimin e aktit të emërimit të ankuesit në atë mënyrë që është fshirë pjesa e fjalës "Menaxher" dhe në vend të saj është vendosur fjala "Zyrtar i Lartë" sikurse që ishte përcaktuar edhe me Vendimin Nr.protokoll:35/2017 të datës 15.02.2017 me rastin e transferimit. Po ashtu me këtë vendim specifikohet se korigjimi i emërimit të pozitës nuk prek asnjë të drejtë të ankuesit që burojnë nga marrëdhënia e punës, përfshirë këtu edhe të drejtën në pagë apo gradë (8) me arsyetimin se përcaktimi i emërimit të titullit të pozitës ka qenë lëshim teknik, pasi që ankuesi as përshkrimin e detyrave të punës nuk e ka pasur të menaxherit, ngase një pozitë e tillë nuk ka figuruar as në Organogramin dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Inspektoratit të Punës, sikurse një emërtim i tillë i pozitës nuk figuron si pozitë pune në kuadër të shërbimit civil.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se ka kaluar afati prej pesë (5) vitesh për shfuqizimin e aktit administrativ, në rastin konkret akt emërimit të datës 06.03.2017, Kolegji i Këshillit ka analizuar

dispozitat e nenit 58 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ"*, dhe ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret përmes Vendimit me numër 06/2023 të datës 25.01.2023 nuk është shfuqizuar dhe as nuk është anuluar akti i emërimit me Nr.prot.57/2017 i datës 06.03.2017, sikurse nuk i janë cenuar të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës duke e ruajtur edhe nivelin e gradës dhe pagës, prandaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi ka bërë interpretim të gabuar të dispozitës ligjore të lartcekur ngase në rastin konkret institucioni punëdhënës në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka bërë korrigjimin e aktit të emërimit, vetëm në pjesën e emërtimit të titullit të pozitës sikurse është përcaktuar edhe me rastin e transferimit përmes vendimit të datës Vendimit me nr.prot.35 i datës 15.02.2017, ndërsa është për tu theksuar fakti se ankuesi edhe përpara se të transferohet sipas aktit të emërimit të datës 18.05.2015 ka pasur koeficientin e pagës tetë (8) dhe po ashtu pas transferimit dhe lëshimit të aktit të emërimit të datës 06.03.2017 ankuesit i është ruajtur koeficienti i pagës tetë (8), nga rrjedh se pas korrigjimit të akt emërimit sërish koeficienti ka mbetur tetë (8), prandaj ankuesi nuk është dëmtuar në pagë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se, sipas dispozitave ligjore të nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"1. Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ"*, afati kohor nuk përbën parakusht ligjor dhe as nuk përcaktohet periudhë kohore brenda së cilës është i lejuar të bëhet një korrigjim i tillë i aktit sipas detyrës zyrtare, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, në rastin konkret ankuesit nuk i janë cenuar të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës sikurse është arsyetuar edhe në konstatimet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, gjegjësisht institucioni punëdhënës ka vepruar në pajtim me Vendimin me Nr.prot.35 të datës 15.02.2017 përmes të cilit ankuesi ishte transferuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Inspektoratin e Punës, ku qartë ishte specifikuar titulli i pozitës së punës që ankuesi do të ketë në institucionin e transferuar dhe të njëjtin vendim ankuesi nuk e ka kundërshtuar, sikurse i njëjti nuk ka pasur përshkrim të detyrave të punës për pozitë menaxheriale me rastin e transferimit.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ndërsa ankesa e tij është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, kurse akti i kontestuar përmes kësaj ankese, gjegjësisht Vendimi nr. 06/2023 i datës 25.01.2023 është akt administrativ i ligjshëm sikurse i njëjti i përmbush elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa Inspektorati i punës me rastin e korrigjimit të akt emërimit vepruar në pajtueshmëri me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.302/2023

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

